LIGJ
Nr. 128/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9150, DATË 30.10.2003, "PËR URDHRIN E FARMACISTËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9150, datë 30.10.2003, "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1, pika 2, fjalët "Urdhri i Farmacistëve është ent publik" zëvendësohen me fjalët "Urdhri i Farmacistëve është ent publik jobuxhetor".

Neni 2

Në nenin 3, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Urdhri i Farmacistëve garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit të vendosur nga institucioni përkatës.".

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

1. Urdhri i Farmacistëve, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme, nëpërmjet përfaqësimit ndërinstitucional, me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, me institucionet e saj vartëse si dhe me ministritë e tjera, me institucionet qendrore dhe organizma të tjerë publikë ose jopublikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Farmacistëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrin e Farmacistëve për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën farmaceutike.".

Neni 4

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1. Shkronja "ç" e pikës 1 shfuqizohet.

2. Pas shkronjës "ç", të pikës 1, shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) Presidentët e Urdhrit.".

3. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

"2. Zgjedhjet në organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri"".

Neni 5

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1

Presidentët e Urdhrit

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Farmacistëve me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.

3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Farmacistëve duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;

ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funksioni i presidentëve të Urdhrit të Farmacistëve është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.".

Neni 6

Në nenin 10, pika 2, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.".

b) Fjalia e pestë ndryshohet si më poshtë:

"Zgjedhjet në këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.".

Neni 7

Në nenin 11, pika 2, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, fjalët "mandat 4-vjeçar" zëvendësohen me fjalët "mandat 5-vjeçar".

2. Fjalia e dytë shfuqizohet.

Neni 8

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

1. Këshilli rajonal krijohet në bazë qarku dhe përbëhet nga 5 deri 9 anëtarë në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit, në qark.

2. Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësin e vet.

3. Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin.".

Neni 9

Në nenin 17, pika 1, shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Gjobat e vjela sipas shkronjës "c", të pikës "1", të këtij neni, derdhen njëqind për qind në Buxhetin e Shtetit.".

Neni 10

Në nenet 10, 11 dhe 16 emërtimi "Asambleja e Përgjithshme" zëvendësohet me emërtimin "Asambleja Kombëtare".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8746, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani